



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.242/2024

GJYKAT SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetari i kolegjit, Valdete Daka dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurës N. M., për shkak të veprave penale keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, nga neni 195, paragrafi 2., lidhur me paragrafin 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 3., pika 3.1., lidhur me paragrafin 1., pika 1.4. të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurës N. M., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Fushë Kosovë, P.nr.182A/23 të datës 04.12.2023 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.1724/2023 të datës 18.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e palejuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurës N. M., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Fushë Kosovë, P.nr.182A/23 të datës 04.12.2023 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.1724/2023 të datës 18.01.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë Dega Fushë Kosovë, me aktvendimin P.nr.182A/23 të datës 04.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës PP.II.nr.5636/23 të datës 03.10.2023, e paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurës N. M., avokati Muharrem Kurtaj.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimi PN.nr.1724/2023 të datës 18.01.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurës N. H., avokati Taulant Ismajli dhe të pandehurës N. M., avokati Muharrem Kurtaj dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurës N. M., avokati Muharrem Kurtaj, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të ngritjes së aktakuzës në procedurën penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës kërkesën ta aprovoi si të bazuar, aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë t'i ndryshojë ashtu që të hedhet aktakuza ose lëndë ta kthej në rigjykim tek shkalla e parë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.II.nr.135/24 e datës 23.04.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurës të hedhet si e palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

-kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e palejuar.

Sipas dispozitës së nenit 432, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale të formës së prerë, ndërsa në rastin konkret procedura penale nuk ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, por kemi të bëjmë me kërkesën për hedhjen e aktakuzë, çka do të thotë se në këtë çështje penale procedura akoma nuk ka përfunduar, prandaj kjo Gjykatë vlerëson se kërkesa në këtë rast nuk është e lejuar.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 435, paragrafi 2. të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.242/2024, më datë 13.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi